



DITAR PUNE I KLUBEVE TË GJELBRA



Projekt i USAID-it Shkollat e Gjelbra

Projekti Shkollat e Gjelbra në kuadër të të cilit është edhe ky botim është financuar nga USAID-i përmes Projektit të Arsimit Fillor të realizuar nga Akademia për Zhvillimin e Arsimit nga SHBA-ja dhe Projektit për Riciklimin e Plastikës të realizuar nga MDC Ti Net nga Maqedonia. Ky botim dhe pjesë të tij mund të riprodhohen në çfarëdo forme përkatëse me kusht që të përmendet si duhet burimi i të dhënave. Të drejtën për shtypin dhe shtypin e serishëm të edicionit e ka Akademia për Zhvillimin e Arsimit dhe MDC Ti Net.

E përgatitën:

Mlica Petrushevska, koordinator i projektit të USAID-it Shkollat e Gjelbra;
Ofelija Petreska, pedagog në SHF “Grigor Përliçev” - Ohër;
Suzana Popovska, arsimtare e gjuhës angleze në SHF “Mirçe Acev” - Shkup;
Dançe Dimçevska, profesoreshë e biologjisë në SHF “Goce Dellçev” - Negotinë;
Shaban Kovaçi, pedagog në SHF “Drita” - f. Rashçe;
Sebijan Fejzulla, asistent i projektit të USAID-it Shkollat e Gjelbra

Ekipi profesional

Zora Gjoshovska, arsimtare e biologjisë në SHF “Grigor Përliçev” - Ohër;
Sunçica Milloshevska Stanojeviq, arsimtare e gjeografisë në SHF “Mirçe Acev” - Shkup;
Mexhdi Ismani, arsimtari i biologjisë në f. Rashçe;
Goran Kimov, arsimtar i biologjisë dhe kimisë në SHF “Goce Dellçev” - Negotinë;
Zule Partinova, arsimtar i biologjisë në SHF “Video Podgorec” - Strumicë;
Risto Tasev, arsimtar i gjeografisë në SHF “Video Podgorec” - Strumicë;

Recension

Anica Aleksova Projekti i USAID-it për arsimin fillor
Nebojsha Mojsoski Projekti i USAID-it për arsimin fillor
Arijan Toska Projekti i USAID-it për reciklim e plastikës

Përktheu nga maqedonisht

Zekerija Ibrahim

Redaktura gjuhësore

Zekerija Ibrahim

Përgatitje teknike

KAD-ING doo Shkup

Shtyp

Botues:

MDC Ti Net
Orce Nikollov 98/1-4
1000 Shkup
Republika e Maqedonisë

DITAR PUNE I KLUBEVE TË GJELBRA

Shkup, 2009



Përmbajtja

Hyrje	5
Njoftimi me temat	6
Evidentimi i Patrullës së Gjelbër	16
Anketimi	22
Intervistat	28
Incizimi i gjendjes infrastrukturore	46
Analiza e të dhënave	66
Forma për projekt	76
Evaluimi	86



Të nderuar anëtarë të Klubit të Gjelbër.

Para vetes e keni ditarin e punës në Klubin e Gjelbër. Ai është hartuar që t'ju shërbejë juve për evidentimin e punës së Klubit dhe të temave: energjia, mbeturinat, uji dhe transporti, si dhe për atë se në çfarë mënyre mund të kontribuoni ju në shkollën tuaj dhe në shtëpi për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Pastaj. Ditari përmban edhe forma të ndryshme me të cilat mund:

- ☆ të bëni mbledhje të të dhënave për nivelin e vetëdijes, të politikës dhe praktikës shkollore, si dhe të gjendjes së infrastrukturës së shkollës, të cilat ndikojnë ndaj mjedisit jetësor.
- ☆ t'i analizoni të dhënat dhe të bëni prioritete për punën e Klubit të Gjelbër;
- ☆ të hartoni projekt për arritjen e qëllimit në shkollë dhe
- ☆ t'i ndiqni dhe t'i evaluoni rezultatet e punës suaj.

Ne shpresojmë se nën udhëheqjen e koordinаторit të Klubit të Gjelbër në shkollën tuaj, ju do të mund të punoni si duhet dhe ta plotësoni këtë ditari dhe kështu, në këtë mënyrë, ju si anëtarë të Klubit të Gjelbër do ta jepni kontributin tuaj për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Ne shpresojmë se puna me këtë ditari do t'ju bëjë kënaqësi dhe ëndje.





NJOFTIMI ME TEMAT



1. Njoftimi me temat

Në këtë pjesë të Ditarit të punës në Klubin e Gjelbër do të gjeni informacione themelore për problemet globale të mjedisit jetësor që kanë të bëjnë me temat: energjia, mbeturinat, uji dhe transporti. Aty do t'i vini re problemet e shkollave në lidhje me këto tema dhe do të mësoni mjeshtëri për atë se si mund të kontribuoni për mbrojtjen e mjedisit jetësor.





1.1 Mbeturinat

Mbeturinë konsiderohet ajo që njerëzit nuk e përdorin më dhe e hedhin. Ne thuaja në çdo aktivitet krijojmë mbeturina: kur gatujmë në kuzhinë, kur e kositim barin në oborr, kur punojmë në zyrë dhe përdorim material zyresh, kur vendosim që mobilet e vjetra t'i zëvendësojmë me të reja. Pra, mbeturina mund të jetë material i ndryshëm: letër, plastikës, dru, xham, mbetje të ushqimit etj.



Mbeturinë komunale.



Mbeturinë plastike.



Mbeturinë druri .

Mbeturina në veçanti është e pakëndshme kur në vend që të hidhet në kontejnerë ose në deponi, njerëzit me qëllim ose rastësisht e hedhin nëpër trotuare, parqe ose rrugë. Kështu, nëse kontejnerët nuk janë të mbyllur si duhet, atë e fryn era ose kafshët mund ta shpërndajnë gjithandej. Mbeturina e hedhur lë përshtypje të parregullsisë dhe ndikon ndaj cilësisë së jetës dhe sigurisë së një vendi të caktuar. Përballja me mbeturinat është një punë e mundimshme dhe e shtrenjtë. Pjesa më e madhe e mbeturinave përfundon në vrima të tokës, në deponi ose digjet në furra të veçanta. Kjo ndikon negativisht ndaj shëndetit të njerëzve për shkak të ndotjes nga deponitë ose nga mbeturinat e djegura. Prandaj ekspertët propozojnë mënyra alternative për t'u ballafaquar me mbeturinat me të cilat do të zvogëlohet sasia e prodhuar e mbeturinave dhe mjedisi jetësor do të ndotet më pak.



Deponia.

Ato janë:

☆Reduktimi, përkatësisht pakësimi i mbeturinës, do të thotë ndryshim i dukshëm i proceseve prodhuese ose të shpërhive blerëse, me ç'rast krijohet më pak mbeturina;



Mbeturinë e hedhur keq pranë rrugës .

☆Ripërdorimi, përkatësisht përdorimi i serishëm i të mirave;

☆Riciklimi dhe kompostimi, përkatësisht krijimi i plehut natyror nga mbeturinat e ushqimit ose mbeturinat e tjera;

Këto tre mënyra janë të njohur si tre R-të: reproduko, ripërdor, riciklo.





Ashtu si në çdo objekt ose mjedis ku jetojnë dhe veprojnë njerëz, ashtu edhe në shkollë krijohet një sasi e caktuar e mbeturinave. Këto mbeturina zakonisht përbëhen nga ushqimi, letra dhe mbeturinat e ambalazhit. Në këto mbeturina po ashtu mund të ketë edhe xhama, metale dhe plastikë. Shkolla shumë shpesh ka probleme me mbeturinat e hedhura në oborrin e shkollës, për çka janë përgjegjës vetë nxënësit. Shkollat me mbeturina të shkapërderdhura jo vetëm që duken keq, por edhe nuk janë të sigurta për nxënësit.

Gjëja e parë dhe më e rëndësishme për t'u ballafaquar me mbeturinat në shkollë është ngritja e vetëdijes se nxënësve përmes ligjëratave, fushatave, organizimeve etj. Pastaj në shkollë duhet të ketë numër të mjaftueshëm të kovave për plehra, të cilat do të vendosen si duhet nëpër klasa, korridore dhe në oborrin e shkollës. Njëra nga mënyrat më të sigurta për zvogëlimin e mbeturinave është përzgjedhja e asaj që mund të përdoret përsëri ose që mund të riciklohet. Nëse xhami, letra dhe plastika ndahen nga mbeturinat e tjera, ato mund të riciklohen dhe përsëri të përdoren. Kështu, për shembull, shkolla mund të inkuadrojë skemë për mbledhjen dhe riciklimin e letrës dhe të plastikës.

Që ta pakësojë ndikimin e tij të dëmshëm ndaj ambientit jetësor, shkolla duhet ta mirëmbajë oborrin, t'i shqyrtojë mundësitë për përballje alternative me mbeturinat, si dhe të veprojë në mënyrë adekuate në lidhje me ato. Oborri i pastër i shkollës do të kontribuojë për shëndet më të mirë të nxënësve dhe të punësuarve në shkollë, do të jetë vend më i sigurt për ta kaluar kohën në lojë dhe do të ndikojë në mënyrë pozitive ndaj imazhit të shkollës te prindërit dhe te popullata lokale.



Kontejnerë për ndarjen e plastikës dhe letrës: i kaltri është për plastikë, i verdhi për letër.

Këshilla për përballje me mbeturinat:

- ☆ Mbeturinat hidhi në kovën e mbeturinave!
- ☆ Ndaje dhe ricikloje plastikën!
- ☆ Shishet e plastikës hidhi në kontejnerin e plastikës!
- ☆ Bëni në shkollë program për mbledhjen dhe riciklimin e plastikës dhe të letrës!



Llojet e kontejnerëve: për në rrugë dhe për në oborr.



Nxënësit e ndajnë plastikën në shkollën e tyre.

1.2 ENERGJIA

Energjia është mundësi që të kryhet ndonjë punë. Ajo shfaqet në natyrë në shumë forma, si dritë, nxehtësi, si energji mekanike, elektrike, kimike dhe nukleare. Gjatë historisë njeriu ka mësuar si ta ndryshojë energjinë nga një lloj në tjetrin dhe si ta përmirësojë jetën e tij përmes saj. Kështu sot vështirë do të mund ta paramendojnë përditshmërinë tonë pa energji. Për shembull, si do të dukej jeta jonë pa energji elektrike? Nuk do të kishim televizor në shtëpi, as shporet, as kompjuter e as petkalarëse. Në shkollë nuk do të mund të punonim në ndërrimin e dytë, sepse do të ishte shumë terr pa llambat që bëjnë dritë me energji elektrike. As makinat nëpër fabrika nuk do të punonin. Me fjalë të tjera, jeta jonë do të ndryshonte plotësisht dhe gjithësi do ta humbte cilësinë e saj.

Energjinë e fitojmë nga burimet natyrore të energjisë. Ato mund të jenë të ripërtëritshme dhe të paripërtëritshme. Të ripërtëritshme do të thotë se sado që të harxhojmë energji nga burimi, ajo vazhdon të përtërihet dhe prandaj asnjëherë nuk mund të harxhohet. Shembuj të burimeve të



Burimet e ripërtëritshme të energjisë: panelet solare, mulliri i erës dhe burimi gjeotermal.

përtëritshme të energjisë janë dielli dhe era. Sado që ta harxhojmë ngrohtësinë dhe dritën e diellit, ato vazhdimisht përtërihen. Sado që ta harxhojmë energjinë mekanike të erës, ajo përsëri do të fryjë. Shembuj të energjisë së paripërtëritshme janë qymyri dhe nafta, përkatësisht lëndët djegëse nga fosilet. Kur ato digjen, lirojnë energji e cila përdoret në shumë veprimtari, si në ngrohjen e shtëpive, lëvizjen e veturave, pastaj përdoret për prodhimin e energjisë elektrike etj. Por, nafta dhe qymyri janë krijuar para shumë miliona viteve vetëm në sasi të kufizuara që mund të harxhohen dhe të cilat nuk përtërihen.

Që nga revolucioni industrial kah fundi i shek. 18-të dhe në fillim të shek. 19-të e deri në ditët tona njeriu thuhet se ka shterë të gjitha burimet e paripërtëritshme të energjisë. Rezervat e tyre janë shumë të pakta dhe prandaj duhet të kursehen. Në anën tjetër gjatë djegies se lëndëve djegëse me prejardhje nga fosilet lirohet dyoksidi i karbonit, i cili është njëri ndër gazrat e kopshtit të qelqtë dhe i cili kontribuon për ngrohjen globale. Prandaj duhet të orientohemi kah përdorimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë, si dielli, era dhe uji në vend të burimeve të paripërtëritshme të energjisë: nafta, qymyri dhe gazi natyror. Kështu do të ndihmojmë që rezervat aktuale të lëndëve djegëse me prejardhje nga fosilet të zgjasin më shumë dhe kështu do ta pengojmë emetimin e dyoksidit të karbonit në atmosferë, me çka do ta ngadalësojmë ngrohjen globale.



Burimet e paripërtëritshme të energjisë: xehja e qymyrit dhe burimi i naftës.



Energjia përdoret edhe në shkollën tonë, si për ndriçim dhe ngrohje të shkollës, për punën e kompjuterëve, si dhe për punën e pajisjeve të tjera në shkollë, në kuzhinën e shkollës, për ngrohjen e ujit dhe për gatim. Pra, energjinë mund ta përdorim dhe ta kursejmë në mënyrë racionale edhe në shkollë. Këtë mund ta bëjmë me ndryshime të vogla në sjelljen tonë, por edhe në sjelljen e nxënësve të tjerë, si dhe të arsimtarëve në shkollë. Pastaj për kursim kontribuojnë edhe ndërhyrjet e vogla infrastrukturore në shkollë që bashkë me sjelljen shembullore të nxënësve dhe të arsimtarëve mund të bëjnë kursimin e energjisë edhe deri në 10%. Në këtë mënyrë edhe shkolla jonë do të kontribuojë për kursimin lëndëve djegëse me prejardhje të fosileve, për zvogëlimin e emetimit të dyoksidit të karbonit në ajër, për mbrojtjen e shëndetit, por edhe për kursim mjetesh financiare.

Këshilla për shpenzimin racional të energjisë:

- ☆ Fikni dritat kur ta braktisni klasën, qoftë edhe për kohë të shkurtër.
- ☆ Fikni dritat gjatë ditës.
- ☆ Përdorni llamba kursyese. Ato harxhojnë deri në pesë herë më pak rrymë se llambat e zakonshme.
- ☆ Mbyllni dyert kur ngrohet një hapësirë ose kur e keni lëshuar kondicionerin.
- ☆ Shkyçeni krejt televizorin, kompjuterin ose aparatet e tjera.
- ☆ Izoloni dyert dhe dritaret.
- ☆ Kur ju vjen ftohtë, vishni veshje më të ngrohtë në vend që ta lëshoni ngrohjen më shumë.
- ☆ Vendosni perde në hapësirat që rrini, sepse ato gjatë dimrit e mbajnë nxehtësinë brenda, ndërsa gjatë verës nuk lejojnë që ajo të futet brenda.
- ☆ Vendosni shtresë alumini pas radiatorëve. Kjo nuk do të lejojë që nxehtësia të kalojë nëpër mur, por do të kthehet brenda.



Dritat kursyese.



1.3 UJI

Uji ka rëndësi elementare në jetën tonë. Përveç për pije dhe pastrim, uji përdoret edhe në industri, bujqësi, si dhe në prodhimin e cilitdo produkt tjetër. Marrë globalisht, nevojat tona për ujë kanë arritur deri atje sa cikli natyror ujqor nuk mund ta mbajë më tempin.

Sipas prejardhjes, ekzistojnë këto lloje të ujërave: sipërfaqësore (lumenj, liqene, dete, oqeanë); nëntokësore burimet e të cilave gjenden nën sipërfaqen e tokës); atmosferike (shiu, bora, breshëri).

Pa ujë nuk ka jetë. Atë e përdorim çdo ditë. Sot më pak se 2% e rezervave ujore në botë janë ujë i pastër. Derisa të ne ene ka mjaft ujë të pastër për pije, në shumë vende ky është privilegj i rrallë, për shkak të ndotjes së tij, që shpesh shkaktohet nga ujërat e mbeturinave dhe nga mbeturinat kimike. Nevoja për ujë është gjithnjë në rritje, si në amvisëri, ashtu edhe industri.

Ndotësi kryesor i ujit është njeriu. Ujin e ndotin mbeturinat që njeriu nuk i hedh në vend adekuat, ujërat e kanalizimeve,

prodhimet kimike, si dhe fabrikat që lëshojnë ujëra të papastra në lumenj dhe në liqene.



Uji i pastër për pije.



Uji i ndotur.

Në vendet ku ka mungesë të ujit të pastër, uji që përdoret në amvisëri dhe në industri është ujë i ricikluar, përkatësisht i pastruar në mënyrë artificiale, si kompensim për pastrimin e tij natyror përmes avullimit dhe shiut.

ky është një proces i shtrenjtë që e bën të shtrenjtë edhe furnizimin e amvisërive me ujë. Nga ana tjetër, në shumë vende të tjera të botës, për shkak të pozitës së tyre gjeografike, për shkak të klimës, por edhe për shkak zhvillimit të shoqërisë, mungon uji i pastër për pije. Për mungesën e ujit të pastër për pije

kontribuojnë edhe ndryshimet klimatike.

Ujin do ta mbrojmë nga ndotja vetëm me ngritjen e vetëdijes ekologjike të njerëzve dhe përmes miratimit të ligjeve për kontroll të rreptë dhe dënime për të gjithë ata që e ndotin ujin. Konventa Evropiane e Ujërave thotë: “Uji është një trashëgimi e përgjithshme, vlerën e të cilit duhet ta njohin të gjithë. Detyra e secilit prej nesh është që ta përdorë atë me shumë kujdes”.



Pastrimi i ujit.




Shfrytëzimi i kujdesshëm i ujit, si dhe programi efektiv edukativ, mund ta zvogëlojë harxhimin e ujit për dy të tretat dhe të sjellë kursime financiare. Prandaj në çdo rast kur përdoret uji duhet të përkujtohemi në disa këshilla të dobishme që ta japim kontributin tonë në përpjekjet në ruajtjen e këtij burimi të paçmueshëm. Që ta ruajmë ujin të pastër dhe ta kursejmë që ta kemi gjithnjë!



Këshilla për kursimin e ujit:

- ☆ Mbyllni çezmat derisa i lani duart dhe dhëmbët..
- ☆ Aparatet për larjen e enëve dhe të teshave përdorni të mbushura plot.
- ☆ Ujitni vetëm sipërfaqet me bar dhe mos e spërkatni ujin rrugës ose shtigjeve të parkut.
- ☆ Ujitni natën ose herët në mëngjes, që ta evitoni avullimin.
- ☆ Kujdesuni për bimët që kërkojnë më pak ujë.
- ☆ Në vend që t'i lani pemët dhe perimet me curril të fuqishëm, lini të qëndrojnë në enë të mbushura me ujë.
- ☆ Shfrytëzoheni ujin vetëm kur ju duhet me të vërtetë. Çdoherë mbylleni çezmën kur e përfundoni punën.
- ☆ Rregullisht dhe me kohë rregulloni të gjitha çezmat ose kazanët e tualetit që rrjedhin.

Користете вода само толку колку што ви е неопходно.



Ta ruajm ujin e pastërt dhe ta kursejmë për të pasur ujë përgjithmonë!




1.4 Transporti

Transporti është pjesë e jetës së përditshme të njeriut bashkëkohor. Secili prej nesh përdor ndonjë lloj të transportit. Ne përdorim veturë ose autobus që të arrijmë në shkollë ose në punë, tren ose avion që të udhëtojmë jashtë vendit ose që të shkojmë në pushim. Ndonjëherë përdorim edhe anije që të shëtisim nëpër liqen ose në det.

Përdorimi i rritur i veturave ndikon dukshëm, si ndaj mjedisit jetësor dhe shëndetit, ashtu edhe ndaj jetës sociale. Përdorimi gjithnjë e më i madh i veturave shkakton rrëmujë dhe e bën komunikacion më të pasigurt. Statistikat tregojnë se rrugët tona janë të rrezikshme, ndërsa smogu që krijohet prej veturave e dëmton shëndetin dhe mirëqenien tonë. Gazrat e liruar nga veturat kontribuojnë edhe për ngrohjen globale, si dhe për ndotjen e ajrit.

Frika nga rrëmujat në komunikacion, si dhe rreziku nga personat e panjohur, bëjnë që shumë prindër t'i shpijnë fëmijët e tyre në shkollë pikërisht me vetura. Kjo ka shumë pasoja, si ndaj nxënësve, ashtu edhe ndaj mjedisit më të gjerë.



Mjetet e transportit:
Avioni, autobusi, treni
dhe vetura





Hulumtimet kanë dëshmuar se fëmijët që ecin në këmbë deri në shkollë, e rrisin aktivitetin e tyre dhe kështu janë më të fokusuar dhe arrijnë sukses më të madhe në shkollë.

Vozitja e biçikletës dhe ecja janë forma të shkëlqyeshme të aktivitetit fizik, madje rruga deri në shkollë ka rëndësi të veçantë për rritjen e këtij lloji të aktiviteteve. Shprehitë në raport me aktivitetin fizik përvetësohen që nga fëmijëria më e hershme, andaj mungesa e aktivitetit fizik që nga ditë e para krijon rrezik më të madh nga trashja e mëvonshme, shtypja e lartë e gjakut, mirëqenia e dobët psikologjike, si dhe sëmundjet e zembrës. Vozitja e biçikletës dhe ecja rrugës deri në shkollë ndikon edhe ndaj jetës sociale të fëmijës. Ai përvetëson më shumë vetëbesim, miq, përvetëson ndjenjë për pavarësi dhe ndjenjë për komunikacion.

Këshilla për transport ekologjik:

- ☆ Vozit biçikletë!!
- ☆ Ec në këmbë që të jesh më i shëndoshë dhe të jetosh në mjedis më të pastër!
- ☆ Udhëto me transport publik!
- ☆ Shfrytëzo transport të organizuar!
- ☆ Kur je në veturë ose në taksi, mos u vozit vetë!



Përdorimi i transportit publik, ecja dhe vozitja e biçikletës e ruajnë shëndetin tonë dhe mjedisin jetësor!



EVIDENTIMI I PATRULLËS SË GJELBËR



2. Lista evidencës së Patrullës së Gjelbër

Në këtë pjesë do ta gjeni formën përmes së cilës do të mund t'i evidentoni pikëpamjet tuaja gjatë patrullimit në shkollë, në oborrin e shkollës ose në mjedisin përreth shkollës. Patrullimi do të mundësojë që në vazhdimësi të ndiqni se a ekzistojnë ndryshime në sjelljen e nxënësve, arsimtarëve dhe qytetarëve të tjerë ndaj mjedisit të jashtëm, krejt kjo si rezultat i aktiviteteve tuaja në Klubin e Gjelbër.





2. Evidentimi

2.1 Fletë për evidentimin e Patrullës së Gjelbër

Data: _____

Anëtarët e Patrullës së Gjelbër: _____

Rrethoni:

- A) Patrullimi është realizuar në shkollë
- B) Patrullimi është realizuar në oborrin e shkollës
- Γ) Patrullimi është realizuar në rrethinën e shkollës

1. Gjatë patrullimi tuaj a janë të mbushur/zbrazët kontejnerët/shportat e mbeturinave? Shpjegoni pse.

2. A keni hasur në mbeturina jashtë kontejnerëve/kovave të mbeturinave? Nëse keni gjetur, shpjegoni për çfarë mbeturinash është fjala dhe ku. (Në cilën klasë, në cilin korridor, në cilën pjesë të oborrit të shkollës ose ku tjetër jashtë oborrit të shkollës).

3. A keni hasur në shishe të plastikës të përziera me mbeturina të tjera? Nëse keni hasur, shpjegoni hollësisht ku. (Në cilën klasë, në cilin korridor, në cilën pjesë të oborrit të shkollës ose ku tjetër jashtë oborrit të shkollës).



4. A hasët në çezme të prishura nga të cilat rrjedhë ujë pa nevojë? Nëse po, shpjegoni hollësisht sa dhe ku? (Në cilën klasë/tualet, në cilin korridor, në cilën pjesë të oborrit të shkollës ose ku tjetër jashtë oborrit të shkollës).

Empty dashed box for answer to question 4.

5. A hasët në kazanë të prishur në tualete ose në instalim të prishur të ujësjellësit, prej të cilëve rrjedh ujë. Nëse po, shpjegoni hollësisht çka patë dhe ku. (Në cilin tualet, sa kazanë etj.)

Empty dashed box for answer to question 5.

6. A hasët në drita që ndriçojnë edhe ditën kur mjafton drita e diellit? Nëse po, shpjegoni hollësisht sa dhe ku.

Empty dashed box for answer to question 6.

7. A hasët në pajisje elektrike të kyçura që punojnë edhe pse askush nuk i përdor (kondicionerë, bojlerë, kompjuterë, LCD-projektorë etj.)? Nëse po, shpjegoni hollësisht për çfarë pajisjesh është fjalë dhe ku.

Empty dashed box for answer to question 7.

2. Evidentimi



8. A hasët në hapësira me dyer dhe dritare të hapura, ku ishin të lëshuar kondicionerët dhe ngrohja? Nëse keni hasur diçka të tillë, shpjgoni hollësisht se për çka është fjala dhe ku.

9. Gjatë patrullimit a keni vërejtur vetura që bartin vetëm një person deri në shkollë? Nëse keni hasur në vetura të tilla, bisedoni me udhëtarin se a ka pasur mundësi për zgjedhje më ekologjike për transport, si për shembull, ecje në këmbë, udhëtim me biçikletë ose organizim të më shumë udhëtarëve në një veturë. Shpjegojeni situatën hollësisht dhe përmendni shkaqet për zgjedhjen e transportit nga udhëtari. (Për shembull: I pamë 5 udhëtarë që vetë vozisnin veturë deri në shkollë. Tre prej tyre përdorin veturë, sepse nuk kanë mjaft kohë që të ecin në këmbë etj...)

10. Gjatë patrullimit a keni vërejtur nxënës dhe arsimtarë që përdorin biçikletë. Bisedoni me ata për zgjedhjen e tyre të transportit. Shpjegoni më hollësisht sa biçikleta i keni vërejtur gjatë patrullimit dhe pse ata e kanë zgjedhur pikërisht biçikletën si mjet transporti.

11. A keni vërejtur nxënës apo qytetarë që sillen në mënyrë të pahijshme ndaj mjedisit jetësor. Nëse keni vërejtur, përmendi për çfarë sjellje bëhet fjalë dhe çka bëtë ju si masë kundër kësaj?



Përfundim nga patrullimi:

A large rectangular area with a dashed green border, intended for writing the conclusion of the patrol.





ANKETIMI



3. Anketimi

Në këtë pjesë të ditarit do t'i gjeni këto forma:

- ☆ Fletë anketuese për nxënësit, arsimtarët dhe prindërit.
- ☆ Analizë të rezultateve të fituara nga anketa e zbatuar me nxënësit e klasave V-IX.
- ☆ Analizë të rezultateve të fituara nga anketa e zbatuar me arsimtarët.
- ☆ Analizë të rezultateve të fituara nga anketa e realizuar me prindërit.

Me këto forma mund të bëni anketim që të shihni se sa është e zhvilluar vetëdija ekologjike te nxënësit, te prindërit e tyre dhe te arsimtarët. Për këtë qëllim, bëni aq kopje sa ju duhen nga fleta anketuese, ndërsa rezultatet e fituara inkuadroni dhe përpunoni në format e analizës së rezultateve veçmas për secilin grup të anketuar.

Këto forma përdorni edhe:

- ☆ që t'i mblihdni informacionet e para si bazë për krijimin e projektit dhe ,
- ☆ që t'i evaluoni efektet e punës suaj gjatë vitit shkollor.



3.1 Fletë anketuese për nxënësit, arsimtarët dhe prindërit

Qëllimi i anketës është që të përcaktohet vetëdija ekologjike e të anketuarve në këto tema: plehrat, energjia, uji, transporti. Ju lutemi që sinqerisht të përgjigjeni në këto pyetje duke e shënuar shenjën X!

Ju faleminderit!

		Asnjëherë	Ndonjëherë	Çdoherë
1	A i hidhni mbeturinat në vendin e duhur?			
2	A blini prodhime me shenjën për riciklim (tre shigjeta që krijojnë një trekëndësh)?			
3	A e hidhni ambalazhin plastik dhe letrën bashkë me mbeturinat e tjera?			
4	A i lini dritat në shtëpinë tuaj të ndriçojnë pa nevojë?			
5	A i fikni dritat dhe pajisjet elektrike kur e lëshoni hapësirën edhe për kohë të shkurtër?			
6	A e fikni kompjuterin plotësisht pas përdorimit?			
7	A përpiqeni të kurseni rrymë (për shembull: keni drita kursyese ose ndonjë mënyrë tjetër)?			
8	A e ndalni çezmën derisa i lani dhëmbët me brushë?			
9	A harxhohet ujë pa nevojë në shtëpinë tuaj (lëshohet aparatet për larjen e enëve dhe të teshave edhe pse nuk janë të mbushura krejt, ndërsa çezmat dhe kazanët rrjedhin etj.)?			
10	A përpiqeni të kurseni ujë?			
11	A ecni në këmbë deri në shkollë/punë?			
12	A vozisni biçikletë?			
13	A përdorni veturë që të shkoni në punë?			



3.2 Analiza e rezultateve të fituara nga anketa e realizuar me nxënësit e klasave V-IX.

		Gjithsej të anketuar	Asnjëherë (me numër)	Asnjëherë (në përqindje)	Ndonjëherë (me numër)	Ndonjëherë (me përqindje)	Çdoherë (me numër)	Çdoherë (me përqindje)
1	A i hidhni mbeturinat në vendin e duhur?							
2	A blini prodhime me shenjën për riciklim (tre shigjeta që krijojnë një trekëndësh)?							
3	A e hidhni ambalazhin plastik dhe letrën bashkë me mbeturinat e tjera?							
4	A i lini dritat në shtëpinë tuaj të ndriçojnë pa nevojë?							
5	A i fikni dritat dhe pajisjet elektrike kur e lëshoni hapësirën edhe për kohë të shkurtër?							
6	A e fikni kompjuterin plotësisht pas përdorimit?							
7	A përpiqeni të kurseni rrymë (për shembull: keni drita kursyese ose ndonjë mënyrë tjetër)?							
8	A e ndalni çezmën derisa i lani dhëmbët me brushë?							
9	A harxhohet ujë pa nevojë në shtëpinë tuaj (lëshohet aparatet për larjen e enëve dhe të teshave edhe pse nuk janë të mbushura krejt, ndërsa çezmat dhe kazanët rrjedhin etj.)?							
10	A përpiqeni të kurseni ujë?							
11	A ecni në këmbë deri në shkollë/punë?							
12	A vozisni biçikletë?							
13	A përdorni veturë që të shkoni në punë?							

Çka mund të përfundoni nga analiza e vetëdijes ekologjike te nxënësit në raport me temat: energjia, mbeturinat, uji dhe transporti?

Përfundime:

3.3 Analiza e rezultateve të fituara nga anketa e zbatuar me arsimtarët.

		Gjithsej të anketuar	Asnjëherë (me numër)	Asnjëherë (në përqindje)	Ndonjëherë (me numër)	Ndonjëherë (me përqindje)	Çdoherë (me numër)	Çdoherë (me përqindje)
1	A i hidhni mbeturinat në vendin e duhur?							
2	A blini prodhime me shenjën për riciklim (tre shigjeta që krijojnë një trekëndësh)?							
3	A e hidhni ambalazhin plastik dhe letrën bashkë me mbeturinat e tjera?							
4	A i lini dritat në shtëpinë tuaj të ndriçojnë pa nevojë?							
5	A i fikni dritat dhe pajisjet elektrike kur e lëshoni hapësirën edhe për kohë të shkurtër?							
6	A e fikni kompjuterin plotësisht pas përdorimit?							
7	A përpiqeni të kurseni rrymë (për shembull: keni drita kursyese ose ndonjë mënyrë tjetër)?							
8	A e ndalni çezmën derisa i lani dhëmbët me brushë?							
9	A harxhohet ujë pa nevojë në shtëpinë tuaj (lëshohet aparatet për larjen e enëve dhe të teshave edhe pse nuk janë të mbushura krejt, ndërsa çezmat dhe kazanët rrjedhin etj.)?							
10	A përpiqeni të kurseni ujë?							
11	A ecni në këmbë deri në shkollë/punë?							
12	A vozisni biçikletë?							
13	A përdorni veturë që të shkoni në punë?							

Çka mund të përfundoni nga analiza e vetëdijes ekologjike te nxënësit në raport me temat: energjia, mbeturinat, uji dhe transporti?

Përfundime:



3.4 Analiza e rezultateve të fituara nga anketa e realizuar me prindërit.

		Gjithsej të anketuar	Asnjëherë (me numër)	Asnjëherë (në përqindje)	Ndonjëherë (me numër)	Ndonjëherë (me përqindje)	Çdoherë (me numër)	Çdoherë (me përqindje)
1	A i hidhni mbeturinat në vendin e duhur?							
2	A blini prodhime me shenjën për riciklim (tre shigjeta që krijojnë një trekëndësh)?							
3	A e hidhni ambalazhin plastik dhe letrën bashkë me mbeturinat e tjera?							
4	A i lini dritat në shtëpinë tuaj të ndriçojnë pa nevojë?							
5	A i fikni dritat dhe pajisjet elektrike kur e lëshoni hapësirën edhe për kohë të shkurtër?							
6	A e fikni kompjuterin plotësisht pas përdorimit?							
7	A përpiqeni të kurseni rrymë (për shembull: keni drita kursyese ose ndonjë mënyrë tjetër)?							
8	A e ndalni çezmën derisa i lani dhëmbët me brushë?							
9	A harxhohet ujë pa nevojë në shtëpinë tuaj (lëshohet aparatet për larjen e enëve dhe të teshave edhe pse nuk janë të mbushura krejt, ndërsa çezmat dhe kazanët rrjedhin etj.)?							
10	A përpiqeni të kurseni ujë?							
11	A ecni në këmbë deri në shkollë/punë?							
12	A vozisni biçikletë?							
13	A përdorni veturë që të shkoni në punë?							

Çka mund të përfundoni nga analiza e vetëdijes ekologjike te nxënësit në raport me temat: energjia, mbeturinat, uji dhe transporti?

Përfundime:



INTERVISTAT




4. Format e intervistës

Në këtë pjesë të Ditarit do të gjeni forma për intervistë me ekipin administrativo-technik dhe menaxherial në shkollë që të merrni vesh më shumë për politikën dhe praktikën shkollore në raport me aspektet e mjedisit jetësor, energjisë, mbeturinave, ujit dhe transportit. Format e intervistës janë përgatitur veçmas për drejtorin dhe personelin administrativo-technik dhe veçmas për temat e dhëna.

- ☆ Mbeturinat - forma të intervistës me personelin teknik.
- ☆ Mbeturinat - forma të intervistës me drejtorin
- ☆ Energjia - forma të intervistës me personelin teknik.
- ☆ Energjia - forma të intervistës me drejtorin
- ☆ Uji - forma të intervistës me personelin teknik.
- ☆ Uji - forma të intervistës me personelin teknik.
- ☆ Transporti - forma të intervistës me drejtorin.

Këto forma përdorni edhe:

- ☆ që të merrni të dhëna elementare si bazë për hartimin e projektit dhe
- ☆ që t'i evaluoni efektet e punës suaj gjatë vitit shkollor.





4.1.1 Intervistë me shërbyesin, nikoqirin dhe pastruesin e shkollës.

Data: _____

Bisedën e zhvilloi: _____

Bisedoni me shërbyesin, me nikoqirin dhe me pastruesin e shkollës, varësisht nga ajo se kush mund t'ju përgjigjet në pyetjet e dhëna më poshtë. Në tabelën e dhënë në vendet e zbrazëta nën pyetje shkruani përgjigjet e shërbyesit, të nikoqirit ose të pastruesit të shkollës. Kërkoni të dhëna dhe shpjegime sa më të hollësishme dhe më precize!

1. Sa herë gjatë një dite zbrazen kovat e mbeturinave nëpër klasa? Shpjegoni. (Për shembull: dy herë në ditë, pas përfundimit të secilit ndërrim.)

2. Sa herë gjatë një dite zbrazen kovat e mbeturinave nëpër korridore? (Për shembull: katër herë gjatë një dite, pas secilit pushim të gjatë dhe pas përfundimit të ndërrimit.)

3. Sa herë gjatë një jave pastrohet oborri i shkollës? Shpjegoni. (Për shembull: e pastrojmë çdo ditë të javës nga dy herë, pas përfundimit të secilit ndërrim.)

4. Sa herë gjatë një muaji ndërmarrja e pastrimit të komunës i mbledh mbeturinat nga shkolla? (Për shembull: sipas nevojës, më shpesh se dy herë gjatë javës.)



5. Çfarë sasive të mbeturinave krijon shkolla gjatë një dite? Numëronin thasët e mbeturinave bashkë me shërbyesin ditën kur bisedoni me të.

Empty dashed box for notes.

Çka mund të përfundoni nga intervistat për praktikën shkollore në raport me mbeturinat?

Përfundime





4.1.2 Intervistë me drejtorin e shkollës.

Data: _____

Bisedën e zhvilloi: _____

Bisedoni me drejtorin e shkollës. Në tabelën e dhënë në vendet e zbrazëta në vijat e zbrazëta nën pyetje shkruani përgjigjet e drejtorit të shkollës. Kërkoni sa më shumë të dhëna dhe shpjegime më të hollësishme dhe më precize!

1. A ka krijuar shkolla skemë për mbledhjen dhe riciklimin e letrës së vjetër? Nëse ka, përshkruajeni shkurtimisht.

Empty dashed box for answer to question 1.

2. A ka krijuar shkolla skemë për mbledhjen dhe riciklimin e plastikës? Nëse ka, përshkruajeni shkurtimisht.

Empty dashed box for answer to question 2.

3. A ka lidhur shkolla marrëveshje me kompaninë lokale për blerjen e letrës së vjetër, përfshirë edhe transportin e letrës? Nëse ka, jepni të dhënat e marrëveshjes.

Empty dashed box for answer to question 3.

4. A ka lidhur shkolla marrëveshje me kompaninë lokale për blerjen e plastikës për riciklim, përfshirë edhe transportin e plastikës? Nëse ka, jepni të dhënat e marrëveshjes.

Empty dashed box for answer to question 4.



5. A ka në shkollë hapësirë në të cilën ruhet letra e vjetër, para se të blihet?

Empty dashed box for answer to question 5.

6. A ka në shkollë hapësirë në të cilën ruhet plastika e mbledhur për riciklim para se të blihet?

Empty dashed box for answer to question 6.

7. Çfarë skeme për mbledhje dhe riciklim të plastikës dhe letrës mund të vendoset në shkollë (nëse nuk ka)? Shpjegoni.

Empty dashed box for answer to question 7.

Çka mund të përfundoni nga intervista për praktikat shkollore në raport me mbeturinat?

Përfundime:

Large empty dashed box for final conclusions.





4.2.1 Intervistë me shërbyesin, nikoqirin dhe pastruesin e shkollës.

Data: _____

Bisedën e zhvilloi: _____

Bisedoni me shërbyesin, me nikoqirin dhe me pastruesin e shkollës, varësisht nga ajo se kush mund t'ju përgjigjet në pyetjet e dhëna më poshtë. Në tabelën e dhënë në vendet e zbrazëta nën pyetje shkruani përgjigjet e shërbyesit, të nikoqirit ose të pastruesit të shkollës. Kërkoni të dhëna dhe shpjegime sa më të hollësishme dhe më precize!

1. Sa herë e kontrolloni rregullshmërinë e dritave, ndërprerësve dhe të prizave në klasa, në korridore, në tualete dhe në hapësirat e tjera në shkollë (Për shembull: çdo ditë, një/dy herë në javë, një herë në muaj etj.)? Shpjegoni.

2. Sa herë e kontrolloni rregullshmërinë e dymve dhe të dritareve në klasa, në korridore, në tualete dhe në hapësirat e tjera në shkollë (Për shembull: çdo ditë, një/dy herë në javë, një herë në muaj etj.)? Shpjegoni.

3. Sa herë e kontrolloni rregullshmërinë e dymve dhe të dritareve në klasa, në korridore, në tualete dhe në hapësirat e tjera në shkollë (Për shembull: çdo ditë, një/dy herë në javë, një herë në muaj etj.)? Shpjegoni.

4. Kë e informoni për defektet që i hasni gjatë kontrollit?



5. Për çfarë afati kohor bëhet zëvendësimi i defekteve të paraqitura (Për shembull: gjatë ditës së njëjtë, javën e njëjtë, varësisht nga defekti etj.)? Shpjegoni.

6. Sa herë e kontrollon EVN-ja se a punon në rregull matësi i energjisë së harxhuar elektrike (matësi i rrymës) në shkollë? A ka shkolla marrëveshje me EVN-në për projekte të këtilla? Shpjegoni.

7. Sa herë e kontrolloni se a janë të mbyllura të gjitha dyert pas përfundimit të një ndërrimi (Për shembull: çdo ditë në fund të orarit të punës, kohë pas kohe, kam/nuk kam detyrime të tilla etj.)? Shpjegoni.

8. Sa shpesh e kontrolloni se a janë fikur të gjitha dritat pas përfundimit të ndërrimit të parë dhe të dytë në shkollë (Për shembull: çdo ditë në fund të orarit të punës, kohe pas kohe, kam/nuk kam detyrime të tilla etj.)? Shpjegoni.

Çka mund të përfundoni nga intervista për praktikën shkollë në raport me energjinë?

Përfundime:



4.2.2 Intervista me drejtorin.

Data: _____

Bisedën e zhvilloi: _____

Bisedoni me drejtorin e shkollës. Në tabelën e dhënë në vendet e zbrazëta në vijat e zbrazëta nën pyetje shkruani përgjigjet e drejtorit të shkollës. Kërkoni sa më shumë të dhëna dhe shpjegime më të hollësishme dhe më precize!

1. Sa herë gjatë një viti shkollor organizohen ligjërata edukative në shkollë në temën Energjia dhe përdorimi racional i energjisë (Për shembull: një herë në muaj, tre herë në vit, nuk organizohen fare etj.)? Shpjegoni!

2. A ka në shkollë mesazhe për kursimin e energjisë në klasa, tualete, zyra, kabinete dhe në hapësira të tjera? Shpjegoni!

3. A keni reaguar në rastet kur shkollës i ka ardhur llogari shumë e lartë për rrymë ose për ngrohje? Si keni reaguar?

4. A keni njeri që është i detyruar ta kontrollojë gjendjen e atyre klasave në të cilat nuk ka mësim (a janë fikur të gjitha dritat, a janë mbyllur të gjitha dyert, a janë mbyllur të gjitha dritaret etj.)? Sa herë e kontrolloni gjendjen (për shembull: çdo ditë pas përfundimit të secilës orë, kohë pas kohe etj.)? Shpjegoni më hollësisht!



5. A ka shkolla marrëveshje me elektroekonominë për kontrollin e rregullshmërisë së energjisë elektrike?

Empty dashed box for answer to question 5.

6. A ka mundësi shkolla për vendosjen e dritave? Ku mendoni se është më së miri të vihen dritat e përkohshme? Shpjegoni më hollësisht!

Empty dashed box for answer to question 6.

7. A përdoren në shkollë drita energjetike efikase, pa fije zjarri?

Empty dashed box for answer to question 7.

8. A ka shkolla marrëveshje me ndonjë ndërmarrje për kontrollimin e rregullshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të ngrohjes në shkollë?

Empty dashed box for answer to question 8.

9. A do të vendosnit perde në klasa dhe në hapësirat e tjera nëse kjo ndihmon në kursimin e energjisë së ngrohjes? Ku do t'i vendosnit? Shpjegoni më hollësisht!

Empty dashed box for answer to question 9.

10. A planifikohet ndërrimi i dritareve dhe dyerve që nuk sigurojnë efikasitet energjetik për shkollën?

Empty dashed box for answer to question 10.



11. Cilat masa do t'i ndërmerrni për përdorimin më racional të energjisë në shkollë?

A large empty rectangular box with a dashed green border, intended for the respondent to write their answer.

Çka mund të përfundoni nga intervista për politikën shkollore në raport me energjinë?


Përfundime:

A large empty rectangular box with a dashed green border, intended for the respondent to write their conclusions.



Shirne ditëm





4.3.1 Intervistë me shërbyesin, nikoqirin dhe pastruesin e shkollës.

Data: _____

Bisedën e zhvilloi: _____

Në këtë pjesë të ditarit do të gjeni shpjegim të shkurtër për atë çka është projekti, si dhe formë për projekt. Projekti është shumë e aktiviteteve që realizohen në afat të caktuar kohor, ndërsa efektet e së cilës i afrohen qëllimit që i kemi shtruar para vetes që ta tejkalojmë ndonjë problem. Shfrytëzojeni formën që të krijoni projekt për problemin parësor dhe qëllimin që e keni identifikuar gjatë analizës. Nëse mendoni se duhet të krijoni më shumë projekte për më shumë probleme, bëni kopje të formës. Sidoqoftë, rekomandojmë që gjatë një viti shkollor ta zgjidhni një problem për ta tejkaluar, me qëllim që të hartoni një projekt.

Sipas formës që duhet ta plotësoni ju, janë dhënë edhe shembuj të projekteve për secilën temë veçmas. Shqyrtoni para se ta hartoni projektin tuaj që pastaj ta keni më të qartë si të mendoni.



Çka është projekti?

Projekti paraqet aktivitet të përkohshëm ose shumë të aktivitetëve të përkufizuara me fillim dhe fund të mirë, që realizohen në afat të caktuar kohor dhe për të cilat janë përcaktuar mjetet financiare (buxhet), që ashtu të arrihen qëllimet dhe rezultatet e caktuara me qëllim që të realizohet ndryshimi i dëshiruar.

Prej ku buron fjala?

Fjala “projekt” buron nga fjala latine “projectum” që është nxjerrë nga fjala angleze “proicere”, që e ka pasur kuptimin e hedh diçka përpara. Folja “proicere” është e përbërë nga dy pjesë: nga pjesa “pro” - që nënkupton diçka që i paraparin aktivitetit të shprehur në pjesën vijuese të fjalës dhe nga pjesa “icere” që nënkupton hedh. Kështu fjala projekt në kuptimin e saj origjinal nënkupton diçka që ndodhë para se të ndodhë gjithçka tjetër. Kur filloi të zbatohet fjala projekt në gjuhën tonë, ajo para së gjithash e kishte kuptimin e planit, pra jo të vetë aktit të kryerjes së planit. Më shpesh është përdorë në kuptim të planit të përpunuar të ndonjë objekti të ndërtimitarisë, të makinave etj., ndërsa më rrallë në kuptim të idesë, skicës, konceptit etj. Në njëzet vitet e fundit fjala projekt përdoret gjithnjë e më shumë që ta mbulojë edhe kuptimin e një plani për diçka, por jo edhe të aktivitetëve që zbatohet në pajtim me planin.

Cilat elemente i përmban projekti?

Secili projekti i përmban minimum këto elemente:

- ☆ **qëllimi kryesor** ose ajo që dëshirojmë ta shikojmë si ndryshim në mjedis kur të përfundojë projekti,
- ☆ **aktivitetet** e parashikuara ose ajo që duhet ta bëjmë që ta arrijmë qëllimin,
- ☆ **rezultatet** e aktivitetëve të parashikuara ose ajo që dëshirojmë ta shohim konkretisht si rezultat të asaj që e kemi bërë si aktivitet, ndërsa ajo kontribuon për realizimin e qëllimit,
- ☆ **korniza kohore** (ose afati) si për projektin e gjithmbarshëm, ashtu edhe për secilin aktivitet veçmas,
- ☆ **buxheti i projektit** ose mjetet e parashikuara financiare që janë të nevojshme për zbatimin e aktivitetëve të projektit,
- ☆ **personat përgjegjës** për realizimin e projektit ose njerëzit që në fakt do t'i koordinojnë dhe realizojnë aktivitetet e parashikuara.

Forma për projekt që po jua ofrojmë në këtë ditar i përmban këto elemente.

Në çka duhet të kemi kujdes kur hartojmë projekt?

Sfida themelore gjatë krijimit të projektit dhe gjatë plotësimit të kësaj forme do të jetë që të parashtroni qëllime dhe rezultate të cilat do të mund t'i realizoni duke i pasur parasysh kufizimet kohore dhe financiare, si dhe numrin e njerëzve me të cilët do të punoni. Për shembull, duhet të keni kujdes të keni mjaft kohë dhe mjaft mjete financiare që t'i zbatoni aktivitetet që i keni parashikuar. Nëse nuk keni, zvogëlojeni numrin e aktivitetëve ose mendoni ku mund të gjeni më shumë mjete financiare. Me këtë rast një pjesë të aktivitetëve mund t'i prolongoni për vitin e ardhshëm ose atëherë kur do të keni mjete. Më tej duhet të keni kujdes në faktin se a kontribuojnë vërtet aktivitetet dhe rezultatet për realizimin e qëllimit. Nëse kontribuojnë, duhet të mendoni si t'i përshtatni aktivitetet ose ndoshta ta ndryshoni qëllimin tuaj. Duhet të keni kujdes edhe a keni mjaft njerëz që t'i realizojnë aktivitetet e projektit. Nëse nuk keni, përsëri do të gjeni mënyrë që të angazhoni më shumë njerëz ose ta zvogëloni numrin e aktivitetëve, që ashtu t'i përshtatni edhe rezultatet edhe qëllimin.



Nëse nuk keni, përsëri do të gjeni mënyrë që të angazhoni më shumë njerëz ose ta zvogëloni numrin e aktiviteteve, që ashtu t'i përshtatni edhe rezultatet edhe qëllimin. Ky nuk është një proces i thjeshtë as për krijuesit me përvojë të projekteve. Prandaj keni durim kur e plotësoni formën e dorëzuar derisa të arrini në diçka që vërtet do të jetë reale dhe e realizueshme si projekt i Klubit të Gjelbër.

Në çka duhet të kemi kujdes kur i punojnë rezultatet e projektit?

Këtu dëshirojmë t'u kushtojmë më shumë kujdes rezultateve, sepse arritja e tyre konsiderohet e patjetërsueshme për arritjen e ndryshimit të planifikuar me qëllimin kryesor. Përveç kësaj, ato mund të na japin edhe informacion të mirë për atë sesi përparojmë në realizimin e projektit. Prandaj gjatë zbatimit të projektit duhet ta përcillni se në çfarë mase janë realizuar rezultatet e projektit. Në Klubet e Gjelbra këtë detyrë e kryejnë Patrullat e Gjelbra:

Nëse nuk i kemi përkufizuar mirë rezultatet e projektit dhe nëse nuk e ndjekim se a janë realizuar ato, mund të përfundojmë me atë që do t'i shpenzojmë të gjitha mjetet që i kemi e asgjë të mos arrijmë. Prandaj, kur t'i përkufizojmë rezultatet gjatë plotësimit të formës patjetër duhet të kemi kujdes që ato të jenë përkufizuar si:

- 1) **Precize** ose që ta dimë saktë se çka dëshirojmë të arrijmë si rezultat. Për shembull, mbajtja e orëve edukative janë shembull i mirë përkundër edukimit të organizuar, sepse përmes shembullit të parë e dimë saktë se çka është edukimit: ai është mbajtje e orëve.
- 2) **Të matshme** ose rezultate që mund t'i matim gjatë zbatimit të projektit. Për shembull: orë edukative të mbajtura në të gjitha 40 klasat e shkollës. Ky është shembull i mirë, sepse numrin e orëve që kemi parashikuar ta mbajmë është i matshëm, përkatësisht mund ta numërojmë dhe sipas atij numri ta dimë se a kemi realizuar rezultatin.
- 3) **Reale dhe të realizueshme** ose të tilla për të cilat jemi të sigurt se mund t'i nxjerrim. Për shembull, është reale se do të mbajmë orë në të gjitha klasat, por është joreale të presim që të gjithë nxënësit në shkollë do ta ndryshojnë sjelljen e tyre pas orës së mbajtur. E realizueshme është që mbajtjen e orëve në të gjitha klasat në shkollë ta bëjmë për dy muaj, por jo edhe për dy javë.
- 4) **Të kufizuar me kohë**, ose të dime deri kurë duhet të mbrihen rezultatet. Shembullin më lartë mundemi ta zhvillojmë dhe të themi: të mbajtura orë educative në gjithë 40 klasat në shkollë deri në fund të muajit mars.

Shembujt e shenuara në formularin për projekt në këtë ditar do të ju japin kahje të mira për atë se si ti definoni rezultatet e projekteve të juaja duke pasur kujdes për kriteret e shenuara këtu.

Emri i projektit	Qëllimi i projektit	Rezultatet e pritura	Përgjegjës për realizimin e projektit	Koha e realizimit
Arsyetim: (Shpjegoni shkurtimisht problemin që dëshironi ta tejkaloni me këtë projekt. Shpjegoni pse e zgjidhët këtë problem si parësor në raport me problemet e tjera që janë identifikuar nga analiza e të dhënave).				
Buxheti i përgjithshëm:				



7. FORMA PËR PROJEKT



7.1 FORMA PËR PROJEKT

Emri i projektit	Qëllimi i projektit	Rezultatet e pritura	Përgjegjës për realizimin e projektit	Koha e realizimit
Arsyetim: (Shpjegoni shkurtimisht problemin që dëshironi ta tejkaloni me këtë projekt. Shpjegoni pse e zgjidhët këtë problem si parësor në raport me problemet e tjera që janë identifikuar nga analiza e të dhënave).				
Buxheti i përgjithshëm:				

Numri rendor i aktiviteteve	Aktivitetet që do të ndërmerren për arritjen e qëllimit	Rezultatet e pritura na aktivitetet e realizuara	Realizues i aktivitetit	Koha e realizimit
1				
2				
3				
4				
5				

7.2 FORMA PËR PROJEKT – SHEMBULL MBETURINAT



Emri i projektit		Qëllimi i projektit		Rezultatet e pritura		Përgjegjës për realizimin		Koha e realizimit		
Ballafaqimi alternativ me mbeturinat.		Ndarja e plastikës dhe letrës në shkollë.	Ngritja e vetëdijes ekologjike. Numër i zvogëluar i qeseve me mbeturina pa plastika dhe letra në to.	Koordinatorët e Klubit të Gjelbër	Deri në fund të vitit shkollor.					
Arsyetim: (Shpjegojeni shkurtimisht problemin që dëshironi ta tejkaloni me këtë projekt. Shpjegoni pse e zgjidhët këtë problem si parësor në raport me problemet e tjera që janë identifikuar nga analiza e të dhënave).		Në shkollën tonë problem parësor është ballafaqimi me mbeturinat për shkak të vetëdijes së ulët dhe diturisë e shprehive të pakta të anëtarëve të bashkësisë së shkollës, si dhe për shkak të politikës aktuale shkollore. Anketat e realizuara treguan se nxënësit, arsimtarët dhe prindërit nuk i hedhin në kova speciale mbeturinat e letrës dhe plastikës. Në oborrin e shkollës nuk ka kontejnerë për ndarjen e letrës dhe plastikës. Shkolla nuk ka marrëveshje me ndërmarrjen komunale ose me ndonjë riciklues për mbledhjen e plastikës dhe letrës së ndarë nga shkolla.								
Buxheti i përgjithshëm:		Gjithsej 50 2000.00 MKD për: - kontejnerë të veçantë për ndarjen e letrës dhe plastikës - materiale për ngjarje publike.								
Numri rëndor i aktiviteteve		Aktivitetet që do të ndërmerren për arritjen e qëllimit				Rezultatet e pritura na aktivitetet e realizuara		Realizues i aktivitetit		Koha e realizimit
1	Edukimi i nxënësve përmes mbajtjes së orëve edukative në klasë për atë pse dhe si ta ndajmë letrën dhe plastikën.	Mbajtja e orëve edukative në secilin klasë të shkollës sonë nga klasa 1 deri në klasën 9.				Anëtarët e Klubit të Gjelbër.		Shkurt-mars .2009		
2	Ngritja e vetëdijes ekologjike të nxënësve dhe arsimtarëve përmes vendosjes së posterëve dhe etiketave nëpër shkolla dhe nëpër korridore për mënyrat alternative të ballafaqimit me mbeturinat.	Vendosja e posterëve në vend të dukshëm, së paku në secilin korridor të shkollës. Vendosja e etiketave për ndarjen e letrës dhe plastikës në së paku gjysmen e klasave në shkollë.				Anëtarët e Klubit të Gjelbër.		Shkurt .2009		
3	Nxjtja e rregullt e nxënësve dhe arsimtarëve për ndarjen e plastikës dhe letrës përmes patrullimit të Patrullës së Gjelbër.	Patrullat e Gjelbra e kalojnë gjithë shkollën dhe kontrollojnë a është përzier plastika dhe letra me pjesën tjetër të mbeturinave në shkollë, së paku dy herë në javë dhe së paku pas përfundimit të ndërrimit.				Anëtarët e Klubit të Gjelbër.		Çdo ditë deri në fund të vitit shkollor.		
4	Përpunimi i kovave (nga kutitë e kartonit) për ndarjen e letrës dhe plastikës dhe për vendosjen e secilës prej tyre në klasë.	Përpunimi i kovave për ndarjen e letrës dhe plastikës janë vendosur në secilin klasë.				Anëtarët e Klubit të Gjelbër në bashkëpunim me arsimtarin e artit figurativ dhe me nxënësit e tjerë.		Shkurt .2009		
5	Furnizimi dhe vendosja kontejnerëve për letrë dhe për plastikë në oborrin e shkollës.	Vendosja e së paku 1 kontejneri për letrë dhe 1 kontejneri për plastikë në oborrin e shkollës.				Anëtarët e Klubit të Gjelbër, drejtori.		Mars .2009		
6	Nënshkrimi i marrëveshjes me ndërmarrje private për mbledhjen e plastikës dhe të letrës nga shkolla.	Marrëveshje e nënshkruar me ndërmarrje private.				Anëtarët e Klubit të Gjelbër, drejtori.		Mars .2009		

7.2 FORMA PËR PROJEKT – SHEMBULL ENERGËJIA



Emri i projektit		Qëllimi i projektit		Rezultatet e pritura		Përgjegjës për realizimin e projektit		Koha e realizimit	
Shpenzimi racional i energjisë elektrike në shkollë!		Kursimi i energjisë elektrike në shkollë!		Ngritja e vetëdijes ekologjike në shkollë. Logaritë e zvogëluara për rrymë. Logaritë e zvogëluara për ngrohje në shkollë.		Kordinatorët e Klubit të Gjelbër		Deri në fund të vitit shkollor.	
Arsyetim: (Shpjegojeni shkurtimisht problemin që dëshironi ta tejkaloni me këtë projekt. Shpjegoni pse e zgjodhët këtë problem si parësor në raport me problemet e tjera që janë identifikuar nga analiza e të dhënave).		Në shkollën tonë problem parësor është përdorimi joracional dhe humbja e energjisë elektrike për shkak të vetëdijes së ulët dhe diturisë shprehive joadekuate të anëtarëve të bashkësisë së shkollës. Anketat e realizuara treguan se nxënësit, arsimtarët dhe prindërit nuk e kursejnë energjinë elektrike. Nuk shkojnë nuk filin rregullisht dritat, përdoren drita të zakonshme (gjithsej 20), ka llamba neoni që janë të prishura (gjithsej 20). Askush në shkollë nuk është i ngarkuar ta kontrollojë se a janë të fikura dritat që nuk përdoren.		Në shkollën tonë problem parësor është përdorimi joracional dhe humbja e energjisë elektrike për shkak të vetëdijes së ulët dhe diturisë shprehive joadekuate të anëtarëve të bashkësisë së shkollës. Anketat e realizuara treguan se nxënësit, arsimtarët dhe prindërit nuk e kursejnë energjinë elektrike. Nuk shkojnë nuk filin rregullisht dritat, përdoren drita të zakonshme (gjithsej 20), ka llamba neoni që janë të prishura (gjithsej 20). Askush në shkollë nuk është i ngarkuar ta kontrollojë se a janë të fikura dritat që nuk përdoren.					
Buxheti i përgjithshëm:		Gjithsej 70 400,00 MKD për: - llamba kursyese; - llamba të neoni; - materiale për ngjarje publike.							

Numri pendor i aktiviteteve		Aktivitetet që do të ndërmerren për arritjen e qëllimit		Rezultatet e pritura aktivitetet e zbatuara		Realizues i aktivitetit		Koha e realizimit	
1	Edukimi i nxënësve përmes mbajtjes së orëve edukative në klasa për atë pse dhe si të kursejmë energji elektrike.	Edukimi i nxënësve përmes mbajtjes së orëve edukative në klasa për atë pse dhe si të kursejmë energji elektrike.		Mbajtja e orëve edukative në secilin klasë të shkollës sonë nga klasa 1 deri në klasën 9.		Anëtarët e Klubit të Gjelbër.		Shkurt - Mars 2009.	
2	Ngritja e vetëdijes ekologjike të nxënësve dhe arsimtarëve përmes vendosjes së posterëve dhe etiketave nëpër klasa dhe në korridor për kursimin energjisë elektrike.	Ngritja e vetëdijes ekologjike të nxënësve dhe arsimtarëve përmes vendosjes së posterëve dhe etiketave nëpër klasa dhe në korridor për kursimin energjisë elektrike.		Vendosja e posterëve në vend të dukshëm, së paku në secilin korridor të shkollës. Vendosja e etiketave për kursimin e energjisë elektrike në së paku gjysmën klasave në shkollë.		Anëtarët e Klubit të Gjelbër.		Shkurt 2009	
3	Kursimi i energjisë elektrike përmes patrullimit të Gjelbër dhe fikja e të gjitha dritave që ndriçojnë pa nevojë.	Kursimi i energjisë elektrike përmes patrullimit të Patrullës së Gjelbër dhe fikja e të gjitha dritave që ndriçojnë pa nevojë.		Patrullat e Gjelbra e kalojnë gjithë shkollën dhe i fikin të gjitha dritat që ndriçojnë pa nevojë së paku dy herë në javë dhe së paku pas përfundimit të ndërrimit.		Anëtarët Patrullës së Gjelbër.		Secilin javë deri në fund të vitit shkollor.	
4	Përmirësimi i infrastrukturës së shkollës për kursimin e energjisë elektrike me këmbimin e dritave me drita kursyese.	Përmirësimi i infrastrukturës së shkollës për kursimin e energjisë elektrike me këmbimin e dritave me drita kursyese.		Të gjitha dritat e zakonshme (gjithsej 20) janë zëvendësuar me drita kursyese ose me drita llamba neoni. Të gjitha llambat e djegura të neoni në shkollë (gjithsej 20) janë zëvendësuar me të reja.		Anëtarët e Klubit të Gjelbër. Mjeshtri i shtëpisë.		Deri në fundit të marsit, 2009	
5	Organizimi i ngjarjes publike me rastin e Ditës Botërore për Kursimin e Energjisë.	Organizimi i ngjarjes publike me rastin e Ditës Botërore për Kursimin e Energjisë.		Në Ditën Botërore për Kursimin e Energjisë është mbajtur shfaqje dhe tribunë publike.		Anëtarët e Klubit të Gjelbër.		Gjatë muajit mars 2009.	



7.2 FORMA PËR PROJEKT - SHEMBULL UJI

Emri i projektit		Qëllimi i projektit		Rezultatet e pritura		Përgjegjësi për realizimin e projektit		Koha e realizimit			
Harxhimi racional i ujit në shkollë!		Kursimi i ujit në shkollë.		Ngritja e vetëdijes ekologjike në shkollë. Logaritë e zvogëluara për ujë.		Koordinatorët e Klubit të Gjelbër		Deri në fund të vitit shkollor.			
Arsyetim: (Shpjegojeni shkurtimisht problemin që dëshironi ta tejkaloni me këtë projekt. Shpjegoni pse e zgjidhët këtë problem si parësor në raport me probleminet e tjera që janë identifikuar nga analiza e të dhënave).		Në shkollën tonë problem parësor është përdorimi joracional i ujit për shkak të vetëdijes së ulët dhe diturisë joadekuatë të anëtarëve të bashkësisë së shkollës. Anketat e realizuara treguan se nxënësit, anëtarët dhe prindërit nuk e kursejnë ujin. Në tualetet e shkollës ka çezma të prishura (gjithsej 6) dhe kazanë të prishur (gjithsej 6). Askush në shkollë nuk është i ngarkuar ta kontrollojë se a janë të mbylltura çezmat mirë pas përdorimit, nga cilat çezmat rrjedhin ujë edhe pas mbylljes, nga sa kazanë rrjedh ujë, sa çezma të prishura dhe të dëmtuara ka, sa kazanë të prishur dhe të dëmtuar ka etj. etj. Nuk ka asnjë çezme me sensor.									


Numri i rëndor i aktivitetëve		Aktivitetet që do të ndërmerren për arritjen e qëllimit		Rezultatet e pritura na aktivitetet e realizuara		Realizues i aktivitetit		Koha e realizimit	
1	Edukimi i nxënësve përmes mbajtjes së orëve edukative në klasa për atë pjesë dhe si ta kursejnë ujin.	Mbajtja e orëve edukative në secilin klasë të shkollës sonë nga klasa 1 deri në klasën 9.		Anëtarët e Klubit të Gjelbër.		Shkurt-mars .2009			
2	Kontrollimi i çezmave dhe kazanëve përmes patrullimit të rregullt të Patrullës së Gjelbër.	Patrullat e Gjelbra së paku dy herë në javë dhe së paku pas përfundimit të ndërrimit i kontrollojnë të gjitha çezmat dhe kazanët në shkollë se a rrjedhin dhe a punojnë mirë.		Anëtarët e Klubit të Gjelbër.		Çdo ditë deri në fund të vitit të shkollor.			
3	Ngritja e vetëdijes ekologjike të nxënësve dhe anëtarëve përmes vendosjes së posterëve dhe etiketave nëpër klasa dhe korridorë për rëndësinë dhe për mënyrat e kursimit të ujit.	Vendosja e posterëve në vend të dukshëm, së paku në secilin korridor të shkollës. Vendosja e etiketave për kursimin e ujit në së paku gjysmën e tualeteve dhe klasave në shkollë.		Anëtarët Patrullës së Gjelbër.		Shkurt 2009			
4	Përmirësimi i infrastrukurës së shkollës për kursimin e ujit me këmbim të çezmave dhe kazanëve të prishur me të mirë.	Të gjitha çezmat e prishura (gjithsej 10) janë zëvendësuar me çezma të reja. Të gjithë kazanët e prishur në shkollë (gjithsej 6) janë zëvendësuar me të rinj. Të gjitha çezmat e prishura (gjithsej 6) janë zëvendësuar me çezma të reja.		Anëtarët e Klubit të Gjelbër, drejtori;		Mars 2009			
5	Organizimi i ngjarjes publike me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Ujërave.	Është mbajtur shfaqje dhe tribunë publike në Ditën Ndërkombëtare të Ujërave.		Anëtarët e Klubit të Gjelbër, anëtarëve.		Mars 2009			



7.2 FORMA PËR PROJEKT - SHEMBULL TRANSPORTI

Emri i projektit		Qëllimi i projektit		Rezultatet e pritura		Përgjegjësi për realizimin e projektit		Koha e realizimit			
Më pak vetura për më shumë shëndet!		Zvogëlimi i transportit me automjete deri në shkollë dhe nga shkolla.		Ngritja e vetëdijes ekologjike. Zvogëlimi i numrit të veturave dhe veturave taksi me të cilat nxënësit dhe arsimtarët vijnë në shkollë.		Kordinatorët e Klubit të Gjelbër		Deri në fund të vitit shkollor			
Arsyetim: (Shpjegojeni shkurtimisht problemin që dëshironi ta tejkaloni me këtë projekt. Shpjegoni pse e zgjidhët këtë problem si parësor në raport me problemin e tjera që janë identifikuar nga analiza e të dhënave).		Në shkollën tonë problem parësor është transporti. Shumë nxënësit dhe arsimtarëve vijnë në shkollë me vetura, me çka e ndotin ajrin dhe e rrisin reziqun e këmbësorëve përreth shkollës. Rrallë përdoret transporti publik, ndërsa në vetura më shpesh ka jo më shumë se dy udhëtarë. Kjo ishte vërejtur nga puna e Patrullës së Gjelbër, si gjatë anketimit dhe intervistës së realizuar. Incizimi i gjendjes ka treguar edhe se nxënësit nuk praktikojnë të vijnë në shkollë me biçikletë në vend të veturës, sepse nuk kanë ku t'i lënë biçikletat në shkollë. Në fund nga të gjitha të dhënat e mbledhura u pa se nxënësit dhe arsimtarët nuk janë të vetëdijshëm për ndikimin negativ nga transporti me automjete ndaj mjedisit, jetësor dhe ndaj shëndetit të njerëzve.		Në shkollën tonë problem parësor është transporti. Shumë nxënësit dhe arsimtarëve vijnë në shkollë me vetura, me çka e ndotin ajrin dhe e rrisin reziqun e këmbësorëve përreth shkollës. Rrallë përdoret transporti publik, ndërsa në vetura më shpesh ka jo më shumë se dy udhëtarë. Kjo ishte vërejtur nga puna e Patrullës së Gjelbër, si gjatë anketimit dhe intervistës së realizuar. Incizimi i gjendjes ka treguar edhe se nxënësit nuk praktikojnë të vijnë në shkollë me biçikletë në vend të veturës, sepse nuk kanë ku t'i lënë biçikletat në shkollë. Në fund nga të gjitha të dhënat e mbledhura u pa se nxënësit dhe arsimtarët nuk janë të vetëdijshëm për ndikimin negativ nga transporti me automjete ndaj mjedisit, jetësor dhe ndaj shëndetit të njerëzve.							

Numri i aktivitetit		Aktivitetet që do të ndërmerren për arritjen e qëllimit		Rezultatet e pritura na aktivitetet e realizuara		Realizues i aktivitetit		Koha e realizimit	
1	Edukimi i nxënësve përmes mbajtjes së orëve edukative në klasa dhe për atë pse dhe si të silleni në mënyrë më ekologjike gjatë zgjedhjes së mjeteve të transportit.	Mbjajtja e orëve edukative në secilin klasë të shkollës sonë nga klasa 1 deri në klasën 9.		Anëtarët e Klubit të Gjelbër.		Shkurt-mars .2009			
2	Përcjellja e numri të automjeteve që vijnë në shkollë përmes patrullimit të rregullt të Patrullës së Gjelbër.	Patrullat e Gjelbra së paku dy herë në javë dhe së paku pas përfundimit të ndërrimit e shënimit numrin e automjeteve me të cilat vijnë nxënësit dhe arsimtarët në shkollë.		Patrullat e Klubit të Gjelbër		Çdo ditë deri në fund të vitit shkollor.			
3	Ngritja e vetëdijes ekologjike të nxënësve dhe arsimtarëve përmes vendosjes së posterëve dhe etiketave nëpër shkollë dhe nëpër korridore.	Vendosja e posterëve në vend të dukshëm, së paku në secilin korridor të shkollës. Vendosja e etiketave së paku në gjysmën e klasave në shkollë.		Anëtarët Patrullës së Gjelbër.		Shkurt .2009			
4	Promovimi i voztjes së biçikletës përmes vendosjes së pengesave për parkimin e biçikletave në oborrin e shkollës.	Gjithsej 15 vende parkimi për biçikletë janë vendosur në pjesën e përparme të oborrit të shkollës.		Anëtarët e Klubit të Gjelbër, mjeshtri i shtëpisë.		Mars 2009			
5	Organizimi i shfaqjes publike me rastin e Ditës Botërore të Planetit.	Mbjajtja e shfaqjes dhe tribunës publike në Ditën Botërore të Planetit.		Anëtarët e Klubit të Gjelbër, arsimtarët		Mars 2009			



EVALUIMI



9. EVALUIMI

Në këtë pjesë të doracakut do të gjeni forma që ta bëni evaluimin ose vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve të Klubit të Gjelbër në shkollë. Për këtë qëllim së pari duhet ta përsëritni anketimin, intervistën dhe incizimin e gjendjes me format e dhëna më parë në doracak. Përmes analizës së të dhënave që i keni mbledhur gjatë anketimit, intervistës dhe incizimit të përsëritur, si dhe përmes krahasimit të asaj analize me analizën që e keni bërë në fillim para hartimit të projektit, do ta shihni gjendjen e re në shkollë, problemet ende që kanë mbetur aktuale, si dhe shkaqet e tyre. Gjatë kësaj përsëri do të ndahen në mënyrë të qartë përparësitë në të cilat mund të fokusoheni në projektin tuaj të ardhshëm. Në ditar ka forma për analizë për secilën nga temat e Klubit të Gjelbër, si:

- ☆ Mbeturinat - Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve të Klubit të Gjelbër.
- ☆ Energjia - Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve të Klubit të Gjelbër.
- ☆ Uji - Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve të Klubit të Gjelbër .
- ☆ Transporti - Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve të Klubit të Gjelbër.





8.1 Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve të Klubit të Gjelbër.

1. Me format e anketimit, intervistës dhe incizimit mblidhni përsëri informacione për gjendjen në lidhje me temën e mbeturinave në shkollën tuaj. Pastaj shfrytëzoni të dhënat që i keni mbledhur, përmbliidhni dhe përshkruajeni gjendjen e mbeturinave në shkollën tuaj dhe në oborrin e shkollës.

Pastaj mund t'u përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme, duke i shkruar përgjigjet në formë të tekstit:

- ☆ Tregoni përfundimet e anketës që i referohen temës së mbeturinave.
- ☆ Tregoni përfundimet e intervistave që i referohen temës së mbeturinave.
- ☆ Sa klasa ka gjithsej në shkollën tuaj?
- ☆ A ka kova për mbeturina në secilën klasë? Kur zbrazen ato? Përshkruajeni më hollësisht gjendjen!
- ☆ A ka mjaft kova mbeturinash në korridoret e shkollës? Kur zbrazen ato? Përshkruajeni më hollësisht gjendjen!
- ☆ A ka mjaft kova mbeturinash dhe kontejnerë në oborrin e shkollës? Kur zbrazen ato? Përshkruajeni më hollësisht gjendjen!
- ☆ Sa ka apo nuk ka mbeturina në shkollë dhe në oborrin e shkollës jashtë kovave dhe kontejnerëve të mbeturinave? Përshkruajeni më hollësisht gjendjen!
- ☆ A ndahet plastika dhe letra nga mbeturinat e tjera në shkollë? Përshkruajeni më hollësisht gjendjen!
- ☆ A ekzistojnë kova të veçanta për plastikë dhe letër në klasa, në korridore, dhe në hapësirat e tjera të shkollës dhe në oborrin e shkollës? Përshkruajeni më hollësisht gjendjen!



2. Në bazë të përshkrimit, tregoni problemet dhe përparësitë kryesore të shkollës gjatë përballjes me mbeturinat, si dhe shkaqet e problemeve.

3. Krahasojeni gjendjen me atë të analizës së të dhënave të kësaj teme, si dhe me problemet dhe përparësitë që i keni identifikuar atëherë dhe tash dhe tregoni se cilat probleme keni arritur t'i zgjidhni ndërkohë me zbatimin e aktiviteteve të projektit tuaj, e cilat kanë ngelur ende si problem që duhet të tejkalohet.



8.2 Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve të Klubit të Gjelbër

1. Me format për anketimin, intervistën dhe incizimin, mbledhni përsëri informacione për gjendjen e temës së energjisë në shkollën tuaj. Pastaj shfrytëzoni të dhënat që i keni mbledhur, përmbledhni dhe përshkruajeni gjendjen e energjisë në shkollën tuaj dhe në oborrin e shkollës.

Me këtë rast mund t'u përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme, duke i shkruar përgjigjet në formë të tekstit:

- ☆ Tregoni përfundimet e anketës që i referohen temës së energjisë.
- ☆ Tregoni përfundimet e intervistës që i referohen temës së energjisë.
- ☆ Sa klasa janë pajisur në shkollën tuaj me kompjuterë? Gjatë incizimit sa kompjuterë që nuk përdorshin ishin të ndezur? Tregoni ku.
- ☆ A shkyçet në mënyrë automatike rrjeti i kompjuterit kur nuk përdoret? Në cilat klasa dhe hapësira të tjera shkyçet e në cilat jo?
- ☆ Me çfarë xhami janë dritaret e shkollës suaj (xham i dyfishtë, i trefishtë ose me termoizolim)? Përshkruajeni më hollësisht gjendjen!
- ☆ Sa dritare nuk mbyllen mirë dhe lëshojnë të fryjë era? Nëse lëshojnë, tregoni ku?
- ☆ Në sa klasa dhe kabinete keni perde, e në sa jo?
- ☆ Aty ku ka perde, a janë ato të përshtatura me gjerësinë e dritareve? Nëse nuk janë, shkruani ku!
- ☆ A mbyllen mirë dyert e hyrjes të klasave dhe kabineteve? Nëse nuk mbyllen mirë dhe lëshojnë të fryjë, tregoni ku!
- ☆ Sa drita janë të djegura? Ku?
- ☆ Sa drita janë të zakonshme (me fije zjarri)? Ku?
- ☆ Gjatë incizimit a kishte dikur drita të kyçura ndonëse mjaftonte drita e natyrës? Ku dhe sa drita?
- ☆ Apunojnë mirë prizat dhe ndërprerësit në klasa? Nëse nuk punojnë mirë, tregoni sa dhe ku!
- ☆ Sa radiatorë nuk punojnë mirë? Përshkruajeni më hollësisht gjendjen!



2. Në bazë të përshkrimit, tregoni problemet dhe përparësitë kryesore të shkollës gjatë shfrytëzimit të energjisë, si dhe shkaqet e problemeve.

3. Krahasojeni gjendjen me atë të analizës së të dhënave të kësaj teme, si dhe me problemet dhe përparësitë që i keni identifikuar atëherë dhe tash dhe tregoni se cilat probleme keni arritur t'i zgjidhni ndërkohë me zbatimin e aktiviteteve të projektit tuaj, e cilat kanë ngelur ende si problem që duhet të tejkalohet.




8.3 Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve të Klubit të Gjelbër

1. Me format e anketimit, intervistës dhe incizimit mblidhni përsëri informacione për gjendjen që ka të bëjë me temën e ujit në shkollën tuaj. Pastaj shfrytëzoni të dhënat që i keni mbledhur, përmbledhni dhe përshkruajeni gjendjen në shkollën tuaj dhe në oborrin e shkollës.

Me këtë rast mund t'u përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme, duke i shkruar përgjigjet në formë të tekstit:

- ☆ Tregoni përfundimet e anketës që i referohen temës së ujit
- ☆ Tregoni përfundimet e intervistës që i referohen temës së ujit.
- ☆ Në sa klasa ka çezma? Sa prej tyre nuk punojnë mirë apo nuk mbyllen mirë? Tregoni ku.
- ☆ Në sa klasa ka lavamanë? Sa prej tyre punojnë mirë apo rrjedhin? Tregoni ku.
- ☆ Sa çezma ka gjithsej në hapësirat e tjera (kabinete, zyra, biblioteka, hapësira të tjera)? Sa prej tyre nuk punojnë mirë apo nuk mbyllen mirë? Tregoni ku.
- ☆ Sa lavamanë ka gjithsej në hapësirat e tjera? Sa prej tyre nuk punojnë mirë apo nuk mbyllen mirë? Tregoni ku.
- ☆ Sa çezma ka gjithsej në të gjitha tualetet (në shkollë, sallën e edukatës fizike, tualetet e arsimtarëve)? Sa prej tyre nuk punojnë mirë apo nuk mbyllen mirë? Tregoni ku.
- ☆ Sa lavamanë ka gjithsej në tualetet e shkollës? Sa prej tyre punojnë mirë apo rrjedhin?
- ☆ Sa kazanë ka gjithsej në tualetet? Prej sa kazanëve nuk lëshohet ujë dhe ku? Sa prej tyre vazhdojnë të rrjedhin pas lëshimit të ujit dhe ku?
- ☆ Sa nyja sanitare ka në tualete? Sa prej tyre rrjedhin dhe ku?
- ☆ Gjatë incizimit a rridhte ujë pa nevojë dhe ku?



2. Në bazë të përshkrimit, tregoni problemet dhe përparësitë kryesore të shkollës gjatë harxhimit të ujit, si dhe shkaqet për problemet e tilla.

3. Krahasojeni gjendjen me atë të analizës së të dhënave të kësaj teme, si dhe me problemet dhe përparësitë që i keni identifikuar atëherë dhe tash dhe tregoni se cilat probleme keni arritur t'i zgjidhni ndërkohë me zbatimin e aktiviteteve të projektit tuaj, e cilat kanë ngelur ende si problem që duhet të tejkalohet.



8.4 Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve të Klubit të Gjelbër

1. Me format e anketimit, intervistës dhe incizimit mblidhni përsëri informacione për gjendjen që ka të bëjë me temën e transportit në shkollën tuaj. Pastaj shfrytëzoni të dhënat që i keni mbledhur, përmbliidhni dhe përshkruajeni gjendjen e transportit në shkollën tuaj dhe në oborrin e shkollës.

Me këtë rast mund t'u përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme, duke i shkruar përgjigjet në formë të tekstit:

- ☆ Tregoni përfundimet e anketës që i referohen temës së transportit
- ☆ Tregoni përfundimet e intervistës që i referohen temës së transportit.
- ☆ A vijnë nxënësit në shkollë me veturë apo me taksì? Kur? Nga sa nxënës ka në vetura ose në taksì? Shpjegoni më hollësisht!
- ☆ A vijnë arsimtarët në shkollë me veturë apo me taksì? Kur? Nga sa arsimtarë ka në vetura ose në taksì? Shpjegoni më hollësisht!
- ☆ Sa nxënës vijnë në shkollë me biçikletë? Kur?
- ☆ Sa arsimtarë vijnë në shkollë me biçikletë? Kur?



2. Në bazë të përshkrimit, tregoni problemet dhe përparësitë kryesore të shkollës në pikëpamje të transportit, si dhe shkaqet për problemet e tilla.

3. Krahasojeni gjendjen me atë të analizës së të dhënave të kësaj teme, si dhe me problemet dhe përparësitë që i keni identifikuar atëherë dhe tash dhe tregoni se cilat probleme keni arritur t'i zgjidhni ndërkohë me zbatimin e aktiviteteve të projektit tuaj, e cilat kanë ngelur ende si problem që duhet të tejkalohet.

Literatura e shfrytëzuar dhe burimet:

The Kid 's ISO 14000 Programme (http://www.iso.org/iso/kidsiso_home.htm)

WIKIPEDIAThe Free Encyclopedia (www.wikipedia.org)

Paketa e gjelbër, Qendra rajonale e Mjedisit Jetësor për Evropën Qendrore dhe Jugore, 2008(<http://www.wikipedia.org>)

Si të bëhemi eko-shkollë, Programi OHO - Nuk kemi planet rezervë, 2008 (<http://www.oxo.org.mk/planeta>)



Green Schools